



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEKNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësisë Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	2573
Data: Datum: Date:	16.09.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 16-09-2024
Nr. 5/2573

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037- në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, kërkesës nr. 2573 të datës 02.09.2024 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Dardania” nxjerr :

V E N D I M

1. Licencohet në nivel Institucional Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - Kolegji “Dardania”, me seli në Prishtinë për periudhën (1) vjeçare sipas vendimit të AKA-s, ref. 1760/24 të datës 28.08.2024.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2573 të datës 02.09.2024 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Dardania”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret për licencim të parapara me bazën ligjore (Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037) dhe aktet tjera nënligjore (Udhëzimin Administrativ për Licencim dhe Rilicencim 25/2012)
Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat aq vite duke u bazuar në vendimin e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, pra sipas dispozitivit të pika 1.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim i MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.

Kryetar i Komisionit

Burim Gashi

